



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr. 8, datë 12.03.2021

PËR

**“PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT ME LEJE TË
BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME TË TJERA,
PËRDORIMIT ME AUTORIZIM TË BURIMIT UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME TË TJERA, NXJERRJES DHE
SHFRYTËZIMIT TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT
PËR QËLLIME TË NDRYSHME”**

Në mbështetje të tabelës nr. 1, nr. rendor 10, 16, 19, të VKM nr. 993, datë 09.12.2020 “Për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkufitare, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre”, Kreut III, pikës 1 shkronja c/ii dhe pikës 4 shkronja e, të VKM nr. 221, datë 26.04.2018, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore” i ndryshuar, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman

VENDOSI:

1. Përcaktimin e tarifave të përdorimit me leje të burimit ujor sipërfaqësor për qëllime të tjera, përdorimit me autorizim të burimit ujor sipërfaqësor për qëllime të tjera, nxjerrjes dhe shfrytëzimit të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime të ndryshme, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KBU SEMAN
BAKI BALA**



TABELA NR.1

Nr.	Tipet e përdorimit të burimit uhor	Tarifa e përdorimit	
1	Përdorim me leje burimi uhor sipërfaqësor për qëllime të tjera (që nuk përfshihen në përdorimet e tjera).	kur përdorimi është < 1 l/sek.	1.5 lek/m ³
		kur përdorimi është ≥ 1 l/sek , < 5 l/sek.	3 lek/m ³
		kur përdorimi është ≥ 5 l/sek.	4.5 lek/m ³
2	Përdorim me autorizim burimi uhor sipërfaqësor për qëllime të tjera (që nuk përfshihen në përdorimet e tjera).	kur përdorimi është < 1 l/sek.	1.5 lek/m ³
		kur përdorimi është ≥ 1 l/sek , < 5 l/sek.	3 lek/m ³
		kur përdorimi është ≥ 5 l/sek.	4.5 lek/m ³
3	Nxjerrje dhe shfrytëzim i ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime të ndryshme (që nuk përfshihen në formularët e tjerë).	kur përdorimi është ≤ 1 l/sek.	4.5 lek/m ³
		kur përdorimi është $>$ l/sek.	9 lek/m ³